



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 16/3/2019 regjistër (JR)
Datë 23.11.2020

Nr. 16/4 i vendimit
Datë 28.12.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 28.12.2020, ditën e hënë, në orën 10:50, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, kërkesën që i përket:

KËRKUES: Arben Zefi, subjekt rivlerësimi, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Interpretimi i vendimit nr. 10, datë 01.7.2020, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), në të cilën kërkonte interpretimin e vendimit nr. 10, datë 01.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjektit të rivlerësimit Arben Zefi, në datën 30.09.2020, i është njoftuar vendimi i plotë i arsyetuar nr. 10, datë 01.7.2020, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese,

për të cilin ka konfirmuar marrjen e tij në datën 1.10.2020. Sipas këtij vendimi të Kolegjit, trupi gjyqësor, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Zefi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

2. Në datën 19.11.2020, subjekti ka paraqitur një kërkesë përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, protokolluar me nr. {***}, datë 23.11.2020 në Kolegj, nëpërmjet së cilës kërkonte interpretimin e vendimit të sipërcituar. Këtë kërkesë ai e ka përcjellë edhe në mënyrë elektronike në adresat: info@kpa.al, më datë 07.12.2020 dhe {***}, më datë 09.12.2020.

II. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit Arben Zefi

3. Z. Arben Zefi është shprehur në kërkesën e tij se është i paqartë për arsyet e shkarkimit nga detyra, pasi Kolegji me vendimin nr. 10, datë 01.07.2020:
 - a) ka rrëzuar plotësisht përfundimin e Komisionit për një prej kriterëve, kriterin për kontrollin e figurës, për të cilin ai është shkarkuar nga Komisioni; si dhe
 - b) ka cenuar në të paktën katër raste vendimmarrjen e Komisionit në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë.
4. Sipas subjektit, në një interpretim literal të vendimit nr. 10, datë 01.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke u lënë në fuqi vendimi i Komisionit, unë jam shkarkuar për të dyja kriteret, kriterin e kontrollit të figurës dhe për vlerësimin e pasurisë (përfshirë dhe kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016). Duke qenë se për kriterin për kontrollin e figurës, Kolegji ka rrëzuar plotësisht përfundimin e Komisionit, interpretimi literal është i pamjaftueshëm për të kuptuar vendimmarrjen e Kolegjit, dhe mbetet i paqartë përputhshmëria e pjesës arsyetuese të vendimit me pjesën urdhëruese. Gjithashtu, ai pasi citon konkluzionin përfundimtar të Kolegjit në pjesën arsyetuese¹ të vendimit, shprehet se, sipas tij, kuptimi logjik është se shkarkimi nga detyra është bërë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
5. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Arben Zefi ka kërkuar interpretimin e vendimit nr. 10, datë 01.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, duke sqaruar/përcaktuar kriterin e shkarkimit të tij nga detyra.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenet 65 dhe 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), si dhe nenin 314 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e kërkesave për interpretim të vendimeve të dhëna prej tij, lidhur me rivlerësimin e subjekteve. Për rrjedhojë, kërkesa në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt interpretimin e një vendimi të Kolegjit, i cili ka vendosur përfundimisht për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Arben Zefi,

¹ “[...] trupi gjyqësor i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit Arben Zefi ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përputhje me nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016”.

bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit dhe është marrë në shqyrtim sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i kërkuessit*

7. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kërkuessi Arben Zefi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 314 të Kodit të Procedurës Civile.
8. Sipas paragrafit të dytë të nenit 314 të Kodit të Procedurës Civile, kërkesa për sqarimin dhe interpretimin e vendimit mund të paraqitet në çdo kohë, gjersa vendimi nuk është ekzekutuar. Vendimi nr. 10, datë 01.07.2020, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas nenit F, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm, për rrjedhojë ky vendim i Kolegjit ka qenë drejtpërdrejt i ekzekutueshëm për subjektin e rivlerësimit Arben Zefi, sipas dispozitivit të tij. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në sa më sipër u arsyetua, vlerëson se z. Zefi nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa e tij për sqarimin dhe interpretimin e vendimit, është bërë për një vendim të Kolegjit që tashmë ishte ekzekutuar.

B. *Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit, lidhur me kërkesën e paraqitur nga z. Arben Zefi*

9. Trupi gjykues thekson se edhe pse subjekti i rivlerësimit u vlerësua se nuk legjitimohej *ratione temporis*, bazuar në nenin 314 të Kodit të Procedurës Civile, me qëllim trajtimin në mënyrë sa më të plotë të kërkesës së tij, shqyrtoi edhe pretendimet e parashtruara prej tij në të.
10. Në lidhje me pretendimin e tij se vendimi nr. 10, datë 01.07.2020, ka rrëzuar plotësisht përfundimin e Komisionit për një prej kriterëve, kriterin për kontrollin e figurës, për të cilin ai është shkarkuar nga Komisioni, dhe për këtë arsye subjekti ka paqartësi nëse Kolegji e ka shkarkuar atë bazuar edhe në këtë kriter, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vendimi në përmbajtjen e tij për çdo shkak ankimi të paraqitur nga subjekti për këtë kriter, ka analizuar dhe vlerësuar qartë dhe në mënyrë të plotë, argumentet e parashtruara në ankim, provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe situatën faktike që rezultonte për subjektin lidhur me kontrollin e kriterit të figurës. Bazuar në situatën faktike të provuar, si dhe në ligjin material të zbatueshëm lidhur me të, trupi gjykues i Kolegjit ka konkluduar përfundimisht se subjekti nuk ndodhej në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke mos e konsideruar atë si shkak shkarkimi, siç ishte konkluduar në vendimin nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.
11. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se vendimi nr. 10, datë 01.07.2020, ka cenuar të paktën në katër raste vendimmarrjen e Komisionit për kriterin e pasurisë dhe, për këtë arsye, subjekti ka paqartësi nëse Kolegji e ka shkarkuar atë edhe për këto çështje, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vendimi në përmbajtjen e tij për çdo shkak ankimi të paraqitur nga subjekti, ka analizuar dhe vlerësuar qartë dhe në mënyrë të plotë argumentet e parashtruara në ankim, provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe situatën faktike që rezultonte për atë shkak ankimi. Bazuar në situatën faktike të provuar, si dhe në ligjin material të zbatueshëm për secilën prej tyre, trupi gjykues i Kolegjit ka konkluduar përfundimisht se pretendimet e subjektit lidhur me këto çështje të kriterit të pasurisë ishin të bazuara, pra ato nuk mund të merreshin në konsideratë si shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, siç ishte konkluduar në vendimin nr. 97, datë 10.01.2019 të Komisionit.
12. Për më tepër, në funksion të qartësisë së konkluzionit të pasqyruar në përmbajtjen e vendimit, trupi gjykues i Kolegjit, në paragrafin 95 të tij, është shprehur se: *Megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuara nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan prej tij si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.*

13. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin F, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe në konkluzionet si më sipër arsyetuar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kërkesa e subjektit të rivlerësimit Arben Zefi për interpretimin e vendimit nr. 10, datë 01.07.2020, të Kolegjit është e pabazuar në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 314 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Arben Zefi për interpretimin e vendimit nr. 10, datë 01.07.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si të pabazuar në prova dhe në ligj.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 28.12.2020.

ANËTAR

Ardian Hajdari

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol Çomo

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha Mulaj

nënshkrimi

RELATORE

Albana Shtylla

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina Rama

nënshkrimi